



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 192, Datë 18.09.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË OST
SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR PERIU DHËN 2025 - 2027**

Në mbështetje të neneve 19, gërma “c”, pika “i”; 21 dhe 55, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456 datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” e ndryshuar; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr.180, datë 08.11.2017; dhe neneve 15, 19, pika 1, gërma “c”; nenit 21, pika 3, dhe 22, pika 1 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1859/1 prot., datë 13.09.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2025-2027”,

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 6004 prot., datë 23.08.2024 (protokolluar me tonën me nr. 1859 prot., datë 03.09.2024), paraqiti kërkesën për aplikim për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025-2027. Aplikimi i OST sh.a., përmban gjithashtu dokumentin (i) “Plani i Investimeve i shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2022 – 2024 dhe 2025 – 2027” dhe (ii) raportin e aktivitetit të vitit 2024, në të cilin pasqyrohet realizimi i të gjithë treguesve ekonomik - financiar për gjashtë mujorin e parë si dhe parashikimet në lidhje me gjashtë mujorin e dytë të vitit 2024.
- Aplikimi për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, që përcillet në ERE duhet të mbështetet në kriteret dhe kushtet që përcaktohen në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, në “Sistemin e njehsuar dhe të standartizuar të llogarive për të licensuarit në

sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018, si dhe në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.

- Në zbatim të pikës 1, të nenit 21 të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”,* i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse. Aplikimi i shoqërisë OST sh.a. është dorëzuar në afat në zbatim të Rregullores.
- Në mbështetje të nenit 21, pikës 4 të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”,* ERE ruan të drejtën për të kërkuar çdo informacion që e konsideron të nevojshëm për vendimmarrjen e saj në lidhje me aplikimin e paraqitur.
- Rezulton se në lidhje me vitin e testimit, shoqëria ka përcjellë raportin e aktivitetit të vitit 2024, në të cilin pasqyrohet realizimi i të gjithë treguesve ekonomik - financiar për gjashtë mujorin e parë si dhe parashikimet në lidhje me gjashtë mujorin e dytë të këtij vitit. Gjithashtu në këtë raport është përfshirë dhe informacioni mbi gjendjen e huave dhe vlerësimin e kostove të borxhit, ku janë paraqitur të dhënat faktike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 si dhe parashikimi për periudhën rregullatore 2025 – 2027.
- Bazuar në *“Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”,* miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, neni 11, përcaktohet se: *“ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e ushtruara nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes në tregun e energjisë elektrike. Këta të fundit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.”*
- Në lidhje me planin e investimeve për periudhën 2025 -2027 rezulton se shoqëria OST sh.a. i ka bashkëlidhur aplikimit për tarifë një raport mbi planin e investimeve për periudhën 2022 – 2024 dhe 2025 – 2027.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës dhe planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit aplikon për një tarifë për një periudhë rregullatore më të madhe se 1 vit, programi i investimeve do të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.
- Plani i investimeve duhet të paraqitet si një kërkesë më vete nga aplikimi për tarifë e cila duhet të shqyrtohet paralelisht me procesin e përcaktimit të tarifës për periudhën e ardhshme rregullatore mbështetur në përcaktimet e neneve 6 dhe 8 të *“Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”* dhe duhet të jetë në përputhje me këtë rregullore.
- Vlerësohet se OST sh.a. duhet të dërgojë në ERE çdo të dhënë/argument apo dokumentacion mbështetës të nevojshëm që do të kërkohej gjatë këtij procesi, gjithashtu dhe të plotësojë të

gjitha kërkesat dhe detyrat që mund të lindin gjatë zhvillimit të seancave teknike dhe seancave publike me palët e përfshira dhe që ndikohet nga efektet e tarifës mesatare të transmetimit të energjisë elektrike në zbatim të akteve ligjore të sipërcituar.

- Në kërkesën për aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025-2027 shoqëria OST sh.a. ka kërkuar miratimin e një tarife mesatare transmetimi prej 1.22 lekë/kWh, ose një rritje prej 45.5% nga tarifa prej 0.85 lekë/kWh në fuqi e miratuar nga bordi i ERE-s me anë të vendimit nr. 72/2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”.
- Gjatë këtij procesi vlerësohet se Analiza e kostove të realizuara por dhe të parashikuara, si dhe e treguesve teknikë, ekonomik dhe financiar të OST sh.a. për periudhën e ardhshme rregullatore do të shërbejë për të vlerësuar nëse shoqëria është në rrethanat të cilat kërkojnë rivlerësimin e nivelit të tarifës mesatare të transmetimit e si rrjedhojë komponentët e të ardhurave të kërkuara/lejuara në zbatim të përcaktimeve të “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike*”, si dhe në mbështetje të përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025-2027.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI